

# RREGULLORE PËR PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE TË PROKURORËVE

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Objekti

Ky akt përcakton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vlerësimin dhe renditjen e prokurorëve që kandidojnë për transferim nëpërmjet procedurës për lëvizje paralele, sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

### Neni 2 Fusha e zbatimit

Rregullat e parashikuara në këtë Rregullore janë të zbatueshme për vlerësimin dhe renditjen e prokurorëve që kandidojnë dhe që përmbushin kushtet ligjore në procedurën për lëvizje paralele për çdo pozicion të lirë të përhershëm, për pozicionet që pritet të bëhen **të lira në mënyrë** të përhershme brenda 3 muajve, si dhe për aq sa është e mundur edhe për pozicionet e lira të përkohshme.

Këto rregulla zbatohen për prokurorët që kandidojnë dhe që përmbushin kushtet ligjore për lëvizjen paralele në pozicionet e mëposhtme:

- a) prokuror në një prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- b) prokuror në një prokurori pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

### Neni 3 Subjektet

Subjekte të **kësaj rregulloreje** janë prokurorët që kandidojnë për lëvizje paralele sipas përcaktimeve të nenit 43, pika 2 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe konkretisht:

- a) prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- b) prokurorët pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm;
- c) prokurorët e komanduar;
- ç) prokurorët në skemë delegimi.

## Neni 4 Përkufizime

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Dosje personale”** nënkupton dosjen e kandidatit sipas përcaktimeve të nenit 38 të Ligjit për Statusin;
- b) **“Këshilli”** është Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- c) **“Komisioni”** është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- ç) **“Kandidat”**, është prokurori që ka paraqitur kërkesën pranë Këshillit për lëvizje paralele;
- d) **“Ligji për Qeverisjen”**, është ligji nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar;
- e) **“Ligji për Statusin”**, është ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar;
- f) **“Lëvizje paralele”** është kalimi me kërkesë i prokurorit:
  - i. nga një pozicion në një prokurori të juridiksionit të përgjithshëm në një pozicion në një prokurori të juridiksionit të përgjithshëm të të njëjtit nivel;
  - ii. nga një pozicion i komanduar në një pozicion në një prokurori të të njëjtit nivel me atë të pozicionit që ka patur përpara komandimit;
  - iii. nga një pozicion i komanduar përkohësisht sipas nenit 40 të Ligjit për Statusin në një pozicion në një prokurori pranë gjykatës të shkallës së parë;
  - iv. ~~nga një pozicion në një prokurori pranë gjykatës të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në një pozicion në një prokurori pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në rastin kur prokurori;~~  
është vlerësuar, të paktën dy herë, me vlerësim jo më të ulët se “shumë mirë”, në dy vlerësimet e fundit, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të Ligjit për Statusin;  
ka shërbyer në skemë delegimi për të paktën katër vjet dhe gjatë kësaj periudhe është eaktuar, të paktën për një vit, në një pozicion në nivel apeli, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të Ligjit për Statusin; **shfuqizuar**
- g) **“Nivel vlerësimi”** është rezultati i përgjithshëm i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit sipas sistemit të vlerësimit të kohës;  
Në rastin e prokurorit të komanduar, njihet si nivel vlerësimi në kuptim të kësaj rregulloreje, vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni ku prokurori është komanduar.  
Në rastin e prokurorit të riemëruar që nuk i është nënshtruar vlerësimit etik dhe profesional ose prokurorit të komanduar që nuk ka vlerësim etik dhe profesional nga institucioni ku është komanduar, nivel vlerësimi në kuptim të kësaj rregulloreje do të konsiderohet vlerësimi i kryer nga Këshilli sipas nenit 49 të Ligjit për Statusin;
- h) **“Periudhë kalimtare”** nënkupton periudhën deri në realizimin e procedurave të vlerësimit sipas Ligjit për Statusin, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, në përputhje me përcaktimin e nenit 25 të Ligjit nr.48/2019 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*;

- i) **“Përvojë në pozicionet e komanduara”** nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit si prokuror i komanduar: në pozicionin e ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese ose në Prokurorinë e Përgjithshme; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës, në organizata ndërkombëtare, në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit sipas nenit 53, pika 2; ose në një institucion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për një interes publik sipas nenit 54, pika 7, të Ligjit për Statusin.
- j) **“Pikëzim”** nënkupton vlerësimin me pikë të secilit kriter sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të rregulluar nga Ligji për Statusin dhe vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- k) **“Pozicion i lirë”** në kuptim të kësaj rregulloreje nënkupton atë pozicion të lirë apo që pritet të bëhet i lirë brenda tre muajve, në një prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë apo të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, që mund të plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele;
- l) **“Pozicion i lirë i përhershëm”** është pozicioni në një prokurori pranë gjykatës të juridiksionit të përgjithshëm, në të cilin nuk ka prokuror të caktuar në mënyrë të përhershme;
- m) **“Pozicion i lirë i përkohshëm”** nënkupton pozicionin në një prokurori pranë një gjykate të juridiksionit të përgjithshëm, kur prokurori që e ka atë në mënyrë të përhershme është në pamundësi për të ushtruar funksionin për të paktën 3 muaj, por ka të drejtën për t’u kthyer;
- n) **“Procedurë lëvizjeje paralele”** nënkupton procesin administrativ të verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit për kandidatët për një pozicion të lirë, si dhe renditjen e kandidatëve të kualifikuar, me qëllim për të përzgjedhur kandidatin e renditur më lart;
- o) **“Relator”** nënkupton anëtarin e përhershëm ose zëvendësues të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës;
- p) **“Vendim verifikimi”** nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për kualifikimin ose skualifikimin e një kandidati, të marrë në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit në një procedurë lëvizjeje paralele;
- q) **“Vendim për renditjen e kandidatëve”** nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të marrë në përfundim të një procedure përzgjedhjeje për lëvizjen paralele, bazuar në 4 kriteret e përcaktuara në nenin 43, pika 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin, si dhe në rregullat e detajuara për kriteret dhe procedurën të përcaktuara në këtë rregullore;
- r) **“Vendim për lëvizjen paralele”** nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për transferimin e kandidatit të renditur më lart në një procedurë përzgjedhjeje;
- s) **“Vjetërsi si magjistrat”** nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit, si prokuror ose gjyqtar, përfshirë edhe si i komanduar, si dhe si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- t) **“Vlerësim i mëparshëm”** vlerësimet më të fundit etike dhe profesionale të kandidatit, duke përfshirë edhe vlerësimin e përsheptuar të kandidatit sipas nenit 97 të ligjit për statusin; vlerësimin e kryer nga institucioni, në të cilin magjistrati është komanduar sipas nenit 53 pika 11 të Ligjit për Statusin si dhe vlerësimin e kandidatit të riemëruar ose të komanduar sipas nenit 49 të Ligjit për Statusin dhe rregullave të vendosura nga Këshilli.

- th) *“Përvojë specifike profesionale”* nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit, e cila i referohet eksperiencës së mëparshme të kandidatit në ushtrimin e kompetencave dhe kryerjen e detyrave që lidhen me atë pozicion, gjatë një periudhe kohore të specifikuar të mëparshme, duke përfshirë edhe përvojat profesionale të posaçme të thelluara, të tilla si në prokurorinë e Posaçme, Apelit apo Prokurorinë e Përgjithshme, kërkimet shkencore të çertifikuara me tituj e grada akademikë”

## KREU II

### RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE

#### Neni 5

#### Shpallja e procedurës së lëvizjes paralele

1. Këshilli organizon, të paktën çdo 3 muaj, procedurën e lëvizjes paralele për çdo pozicion që është i lirë ose që pritet të bëhet i lirë brenda 3 muajve, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, me përjashtim të rasteve kur:
  - a) Nuk ka pozicion të lirë;
  - b) Kjo mund të passjellë cënim të rëndë të funksionalitetit të prokurorive.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, komisioni në fillim të çdo tremujori i paraqet Këshillit relacionin përkatës ku pasqyron të gjitha vendet e lira në prokuroritë e juridiksioni të përgjithshëm dhe i propozon Këshillit:
  - a) të organizojë procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për të gjitha ose vetëm për disa nga pozicionet e lira;
  - b) të shtyjë organizimin e procedurave të lëvizjes paralele për të gjitha pozicionet e lira deri në verifikimin e situatës së moscënimit të rëndë të funksionalitetit të prokurorive.
3. Shpallja e procedurës së lëvizjes paralele për çdo pozicion të lirë bëhet me vendim të Këshillit, mbi propozimin e Komisionit. Këshilli shprehet me vendim edhe në rastet e mos hapjes së procedurës për vendet e lira.
4. Në vendimin e hapjes së procedurës së lëvizjes paralele Këshilli përcakton:
  - a) kushtet ligjore të kandidimit;
  - b) afatin e kandidimit, i cili mund të jetë nga dy deri në katër javë nga data e shpalljes së procedurës;
  - c) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
  - ç) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit;
  - d) të drejtën për të kandiduar deri në 3 pozicione të lira, duke i renditur ato sipas preferencës.
5. Prokurori i interesuar mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira të shpallura, që janë në proces. Prokurori i interesuar që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës. Nëse prokurori i interesuar:

a) nuk ka përcaktuar pozicionet për të cilat kandidon, do të ftohet nga Komisioni që brenda 3 ditëve të bëjë përcaktimin e tyre dhe renditjen sipas preferencës. Komisioni përcakton kandidimet e vlefshme sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë, në rast të mos përcaktimit të tyre nga prokurori i interesuar brenda afatit.

b) rendit në kërkesën e tij më shumë se 3 pozicione të lira, atëherë kandidime të vlefshme konsideron vetëm 3 pozicionet e para në renditje.

c) nuk ka renditur pozicionet sipas preferencës, atëherë kandidime të vlefshme do të konsiderohen tri pozicionet e para, sipas citimit në kërkesë.

ç) kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme do të konsiderohen, 3 pozicionet për të cilat kandidimi është bërë më parë në kohë. Në numrin e pozicioneve nuk llogariten pozicionet nga të cilat kandidati është tërhequr.

## Neni 6

### Dokumentacioni i nevojshëm për kandidim

1. Kandidatët shprehin interesin për kandidim nëpërmjet një kërkesë të cilës i bashkëlidh dokumentacionin e kërkuar nga Këshilli në vendimin për shpalljen e lëvizjes paralele dhe vetëdeklarimin për mos qenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të ligjit për statusin si dhe kopje të çdo dokumentacioni provues për aftësitë dhe kualifikimet e kandidatit që nuk gjenden në dosjen personale.
2. Komisioni ose Relatori në çdo moment mund të kërkojë dokumentacion shtesë ose sqarime nga kandidatët, kur vlerëson se ai është i nevojshëm për procedurën e konkurimit.

## Neni 7

### Rradha e plotësimit të pozicioneve të lira

1. Komisioni identifikon pozicionet e lira apo që pritet të bëhen të lira brenda 3 muajve. Pozicioni i lirë i përhershëm në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm plotësohet me radhë si më poshtë:

a) nga një prokuror i caktuar përkohësisht në këtë pozicion, i cili paraqet kërkesë për caktimin e përhershëm, në rastin e ndryshimit nga Këshilli të këtij pozicioni nga i përkohshëm në të përhershëm sipas nenit 59 të Ligjit për Statusin;

b) nga prokurori që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale apo për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të prokurorive;

c) nga magjistratët që transferohen për shkak të lëvizjes paralele.

ç) nga magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë.

2. Pozicioni i lirë i përhershëm në prokuroritë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm plotësohet me radhë si më poshtë:

a) nga prokurori që ka të drejtën për t'u caktuar në një nivel apeli;

b) nga prokurori që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale apo për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të prokurorive;

- c) nga një prokuror i caktuar përkohësisht në këtë pozicion, i cili paraqet kërkesë për caktimin e përhershëm, në rastin e ndryshimit nga Këshilli të këtij pozicioni nga i përkohshëm në të përhershëm sipas nenit 59 të Ligjit për Statusin;
  - ç) nga magjistratët që transferohen për shkak të lëvizjes paralele.
3. Pozicioni i lirë i përkohshëm në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, plotësohet fillimisht nga prokurori që ka të drejtën për t'u kthyer. Në vijim, ky pozicion plotësohet me radhë sipas rregullave të parashikuara nga pika 1 e këtij neni për prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm si dhe sipas rregullave të parashikuara në pikën 2 të për prokuroritë pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

## Neni 8

### Kushtet ligjore për lëvizjen paralele të prokurorëve

1. Në procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë mund të kandidojë çdo prokuror i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

- a. të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit;
- ç. të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit, përveç rastit të parashikuar nga neni 40 pika 2, germa "b" e Ligjit për Statusin;
- d. të ketë paraqitur kërkesën për transferim nëpërmjet procedurës për lëvizje paralele për pozicionet e lira ose që priten të bëhen të lira sipas vendimit të Këshillit. Kandidati që nuk ka përcaktuar pozicionet për të cilat kandidon, do të konsiderohet se nuk ka paraqitur kërkesë në kuptim të kësaj rregulloreje.

~~2. Në procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm, mund të kandidojë edhe prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, i cili plotëson njërin prej kushteve të mëposhtme:-~~

- ~~a) ka shërbyer në skemë delegimi për të paktën katër vjet dhe gjatë kësaj periudhe është caktuar, të paktën për një vit, në një pozicion në nivel apeli, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të Ligjit për Statusin;-~~
- ~~b) është vlerësuar, të paktën dy herë, me vlerësim jo më të ulët se "shumë mirë", në dy vlerësimet e fundit, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të Ligjit për Statusin. shfuqizohet~~

## Neni 9

### Fazat e procedurës së lëvizjes paralele

1. Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

- a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit;
- b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale. Konkretisht:
  - i. fillimisht shqyrtohen kandidimet e prokurorëve, të cilët kanë dy vlerësime etike dhe profesionale;

- ii. Nëse nuk ka kandidime nga prokurorë me dy vlerësime etike dhe profesionale, atëherë shqyrtohen kandidimet e prokurorëve të cilët kanë një vlerësim etik dhe profesional;
  - iii. Nëse nuk ka as kandidime nga prokurorë me një vlerësim etik dhe profesional, atëherë shqyrtohen kandidimet e prokurorëve, të cilët nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional;
- c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.
2. Për çdo procedurë **transferimi nëpërmjet** lëvizjes paralele, **Këshilli cakton një** relator me short.
  3. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

## **Neni 10**

### **Parimet e renditjes së prokurorëve**

Renditja e prokurorëve kryhet bazuar në parimin e pavarësisë, meritokracisë, promovimit dhe të zhvillimit të karrierës. Procesi i transferimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele mbështetet në parimet e efikasitetit, të procesit të rregullt ligjor si dhe të parimit të konfidencialitetit.

## **Neni 11**

### **Të drejtat e kandidatit**

1. Kandidati njoftohet për relatorin e procedurës së lëvizjes paralele jo më vonë se 3 ditë nga caktimi i tij.
2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit për një nga shkaqet e parashikuara në **Ligjin për qeverisjen ose çdo shkak tjetër ligjor**, jo më vonë se 3 ditë, nga marrja dijani e shkakut të përjashtimit, duke e shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.
3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e saj.
4. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së lëvizjes paralele, me kërkesë, të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.
5. Kandidati ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Në këtë rast kandidati duhet të ketë ushtruar detyrën përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, si dhe të mos jetë vlerësuar për dy vitet e fundit kalendarike. Në këtë rast, procedura e përshpejtuar e vlerësimit të prokurorit kandidues bëhet pjesë e procedurës së lëvizjes paralele që zhvillon Këshilli për pozicionin e lirë.
6. Kandidati i komanduar, të cilit, gjatë apo në përfundim të komandimit, nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni ku ai është komanduar, ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidati

jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49, të Ligjit për Statusin, për aq sa gjejnë zbatim, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Në këtë rast periudha e komandimit duhet të ketë zgjatur jo më pak se një vit kalendarik.

7. Kandidati i riemëruar, i cili nuk ka një vlerësim etik dhe profesional si prokuror ose nuk ka një vlerësim profesional në momentin e riemërimit, nëse ka ushtruar këtë detyrë përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë kryerjen e vlerësimit me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Nëse kandidati nuk ka ushtruar detyrën e prokurorit përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, si dhe nëse para kandidimit ka jo më pak se një vit përvojë profesionale, ai ka të drejtë të kërkojë të vlerësohet për aftësitë profesionale sipas parashikimeve të nenit 49, të Ligjit për Statusin, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
8. Kryesisht, apo mbi kërkesën e **relatorit, komisionit ose** Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kushtet ligjore të kandidimit dhe/ose kriteret e renditjes, si dhe të depozitohet, kur është rasti, dokumente shkresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.
9. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.

## **Neni 12**

### **Dorëheqja dhe përjashtimi për shkak të konfliktit të interesit**

1. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75 të Ligjit për Qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e lëvizjes paralele për atë pozicion të lirë.
2. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos Kryetari i **Këshillit**. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari **i tij. shfuqizohet**
3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e një anëtari të tij.
4. Për nëpunësit e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të Këshillit zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” mbi paaësinë e administratës publike.

## **Neni 13**

### **Afatet**

1. Afatet në procedurën e lëvizjes paralele caktohen në ditë, në javë ose në muaj. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.
2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Afati i përcaktuar në javë mbaron me kalimin e asaj dite, që është e njëjta me ditën, në të cilën ka ndodhur ngjarja, nga e cila ka filluar të ecë afati.
4. Afati i përcaktuar në muaj mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.
5. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.
6. Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24.00 të saj.

#### **Neni 14**

#### **Njoftimet**

1. Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.
2. Adresa elektronike e Këshillit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës së lëvizjes paralele.
3. Adresë elektronike e kandidatit konsiderohet adresa zyrtare e tij, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë Këshillit. Kandidati merr masa për aksesueshmërinë e adresës së tij elektronike.

### **KREU III**

### **FAZA E PARË E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE**

#### **Neni 15**

#### **Fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe caktimi i relatorit**

1. Komisioni, jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit për një pozicion të lirë, i paraqet Këshillit listën e prokurorëve që kanë kandiduar për pozicionin e lirë, duke cituar edhe prokurorët që kanë kandiduar jashtë afatit.
2. Këshilli, në mbledhjen më të parë vendos fillimin e verifikimit të kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit, të parashikuara në germat “a” deri “d” të nenit 8 të kësaj rregulloreje. Në këtë rast, Këshilli përcakton listën e prokurorëve të interesuar që kanë kandiduar për pozicionin e lirë, duke përjashtuar prokurorët që kanë kandiduar jashtë afatit.
3. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti. Me propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit për caktimin e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

## Neni 16

### Identifikimi i kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale

1. Relatori verifikon numrin e vlerësimeve etike dhe profesionale për secilin kandidat, duke bërë kategorizimin e tyre sipas numrit të vlerësimeve që ata kanë, respektivisht me dy vlerësime, me një vlerësim dhe pa asnjë vlerësim. Verifikimi bazohet në të dhënat e dosjeve personale të kandidatëve. Në këtë rast, në llogaritjen e numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale për çdo kandidat, relatori bazohet edhe në vendimin e Këshillit për përfshirjen e kandidatëve, mbi kërkesat e tyre, në programin e vlerësimit të përsheptuar ose në kërkesën e kandidatit për kryerjen e vlerësimit sipas nenit 49 të Ligjit për Statusin.

## Neni 17

### Rradha e shqyrtimit të kandidaturave

1. Procedura e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë fillimisht vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale.
2. Në rastin kur për pozicionin e lirë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kriterëve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional.
3. Nëse për arsyet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë për kandidatin me një vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo vazhdon për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional.
4. Nëse për të njëjtat arsye, procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë edhe për kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo konsiderohet e përfunduar dhe pozicioni rishpallet përsëri.
5. ~~Për pozicionet e lira në një prokurori pranë një gjykate të shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm, shqyrtohen në mënyrë të njëkohëshme kandidimet e prokurorëve në nivel apeli me kandidimet e prokurorëve në shkallë të parë kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 8 pika 2, gërma "a" dhe "b" të kësaj rregulloreje. shfuqizohet~~
6. Për plotësimin e pozicioneve të lira në një prokurori pranë një gjykate të shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm, zbatohen të njëjtat rregulla të parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe katër të këtij neni.

## Neni 18

### Veprimet procedurale të relatorit

1. Pas caktimit të relatorit, kandidati njoftohet për fillimin e verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, për relatorin e procedurës, si dhe për të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë se 3 ditë nga njoftimi ose nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të

përbërës.

**2.** Relatori kujdeset për verifikimin e plotësimit nga kandidatët të kushteve ligjore të kandidimit dhe në veçanti për:

a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit që gjendet në dosjen personale të çdo kandidati apo dhe të atij që paraqitet nga ata gjatë verifikimit;

b) përgatitjen e relacionit për çdo kandidat, ku përshkruhen veprimet e kryera dhe dokumentet e administruara gjatë verifikimit, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për kualifikimin ose jo të kandidatit, duke i bashkëlidhur relacionit kopje të këtyre dokumenteve;

c) përgatitjen e projekt-vendimeve për kualifikimin ose jo për çdo kandidat;

ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

d) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

dh) njoftimet për kandidatët.

**3.** Në rastin e kandidatit, që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, verifikimi i plotësimit nga ai të kushteve ligjore të kandidimit realizohet:

a) nga relatori i procedurës për të cilën verifikimi i kandidatëve ka filluar më parë, në rastin e procedurave me afate të ndryshme të kandidimit për ato pozicione;

b) nga relatori i procedurës për të cilën ka më pak kandidatë, në rastin e fillimit njëkohësisht të verifikimit të kandidatëve për ato pozicione dhe kur kjo nuk është e mundur, nga relatori i procedurës së hapur e para sipas rendit kronologjik të vendimeve të Këshillit për ato pozicione.

## **Neni 19**

### **Veprimet verifikuese të relatorit**

- 1.** Verifikimi i kandidatit në kuadër të një procedurë lëvizje paralele është i vlefshëm edhe për çdo procedurë tjetër kandidimi të njëkohshme për pozicione të lira të të njëjtës fushë të së drejtës.
- 2.** Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale, relatori vlerëson se ka mangësi, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë, për të dhënë sqarime ose për të plotësuar mangësitë. Mungesa e përgjigjes së kandidatit nuk pengon vijimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizjen paralele.
- 3.** Për verifikimin e kriterit të përvojës profesionale në fushën përkatëse të së drejtës të përshtatshme për pozicionin e lirë, relatori kërkon informacion dhe dokumentacion nga prokuroritë ku kandidati ka ushtruar detyrën ose institucioni ku ka qenë i komanduar.
- 4.** Bazuar në gjetjet e verifikimit, nëse vlerëson që mund të procedohet me skualifikimin e kandidatit, pasi vë në dijeni Komisionin, me vendim të këtij të fundit, relatori njofton kandidatin lidhur me gjetjet paraprake dhe dokumentacionin përkatës, si edhe për të drejtën që, brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë në rrugë elektronike dhe/ose në zyrën përkatëse të Këshillit, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.
- 5.** Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuara për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Nëse motivet vlerësohen të justifikuara, relatori i cakton kandidatit

një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e verifikimit.

6. Në rastin kur, në përfundim të afatit të caktuar, kandidati nuk parashtron shpjegime për gjetjet paraprake të verifikimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm, duke e dërguar çështjen menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.
7. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.
8. Në përfundim të verifikimit për çdo kandidat, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e administruar, si dhe projektvendimin për kualifikimin ose jo të kandidatit.

## **Neni 20**

### **Shqyrtimi nga Komisioni**

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke u kujdesur për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes.
2. Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë verifikimit.
3. Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që verifikimi dhe dokumentacioni përkatës është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e verifikimit ose të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet verifikuese dhe/ose dokumentacionin, për të cilët lind nevoja e plotësimit apo saktësisimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

## **Neni 21**

### **Shqyrtimi nga Këshilli**

1. Kryetari i Këshillit, pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatit.
2. Në mbledhjen e Këshillit, relatori parashtron përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, faktet që kanë rezultuar gjatë verifikimit të kandidatit, si dhe jep sqarime për pyetje të anëtarëve të Këshillit.
3. Nëse Këshilli vlerëson se verifikimi i kandidatit nuk është i plotë, ai cakton një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli ngarkon relatorin për plotësimin e mangësive të evidentuara. Në seancën e radhës për shqyrtimin e çështjes, relatori i bën të ditur Këshillit për plotësimin e mangësive të evidentuara.
4. Në përfundim të bisedimeve, Këshilli vendos për miratimin e projektvendimit të verifikimit të kandidatit sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtari. Në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen

në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

5. Pas bisedimit dhe votimit, Këshilli vendos:
  - a. Kualifikimin e kandidatit në procedurën e lëvizjes paralele;
  - b. Skualifikimin e kandidatit nga procedura e lëvizjes paralele;
  - c. Përfundimin për kandidatin të procedurës së lëvizjes paralele për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

## **Neni 22**

### **Vendimi i verifikimit dhe e drejta e ankimit**

1. Vendimi i verifikimit arsyetohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.
2. Vendimi i verifikimit i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 190 të Ligjit për Qeverisjen dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës.
3. Ndaj vendimit të Këshillit për skualifikimin e kandidatit në procedurën e lëvizjes paralele, kandidati mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit dhe shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.
5. Vendimi i Këshillit për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për kandidatin që tërhiqet nga kandidimi, është i paankimueshëm.

## **KREU IV**

### **FAZA E DYTË E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE**

## **Neni 23**

### **Fillimi i procedurës së përzgjedhjes**

1. Procedura e përzgjedhjes fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të [kushteve ligjore të](#) të gjithë kandidatëve dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të tyre.
2. Në procedurën e përzgjedhjes përfshihen të gjithë kandidatët e kualifikuar.

## **Neni 24**

### **Kriteret e renditjes së kandidatëve**

1. Për zbatimin e kriterëve të renditjes së kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale, si rregull konsiderohen vlerësimet e bëra sipas ligjit për statusin dhe vendimeve

përkatëse të Këshillit në zbatim të tij.

2. Kur Këshilli pranon kërkesën e kandidatit për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional sipas parashikimit të nenit 11 pika 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, vlerësimi i kandidatit bëhet pjesë e procedurës së lëvizjes paralele dhe ky vlerësim etik dhe profesional përfshihet në numrin e vlerësimeve të kandidatit.

3. Në rastin e kandidatit të komanduar, niveli i vlerësimit etik dhe profesional i institucionit ku është komanduar, njihet si nivel vlerësimi edhe në kuptim të kësaj rregulloreje, duke mbajtur në konsideratë në këtë rast nivelet e vlerësimit të institucionit sipas ligjit të tij të posaçëm dhe nivelet e vlerësimit sipas sistemit të kohës për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve. Në rastin kur niveli maksimal i vlerësimit etik dhe profesional në institucionin ku kandidati është komanduar është “shumë mirë”, konvertimi sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (Ligjit për Statusin) bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të institucionit ku magjistrati është komanduar	Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (Ligjit për Statusin)
Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Mirë	Mirë
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm

Niveli i vlerësimit konvertohet në pikë sipas sistemit të vlerësimit në fuqi ( Ligjit për Statusin) si më poshtë:

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100
Shumë mirë	89
Mirë	69
Mjaftueshëm	49
I pamjaftueshëm	29

4. Në rastin e kandidatit të komanduar si dhe të kandidatit të riemëruar, vlerësimi për aftësitë profesionale të të cilit kryhet nga Këshilli, sipas parashikimeve të nenit 49 të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, nivelet e vlerësimit sipas pikëve janë si më poshtë:

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	90- 100

Shumë mirë	70-89
Mirë	50-69
Mjaftueshëm	30-49
I pamjaftueshëm	0-29

## Neni 25

### Hapat e renditjes së kandidatëve me dy vlerësime etike dhe profesionale

1. Për renditjen e kandidatëve me dy vlerësime etike dhe profesionale ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 7, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në këtë vendim.
2. Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.

## Neni 26

### Përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë

1. Rënditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.
2. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:
  - a) “niveli i vlerësimit të fundit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart;
  - b) *“përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit për prokurorët të cilëve u ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit, që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar pasi ka kryer të gjithë periudhën e komandimit”*. - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;
  - c) *“shumëllojshmëria e përvojave, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar”*. - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.
  - ç) *“kohëzgjatja e përvojës, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar”*. - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;
3. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në pikëzim, sipas skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli në lidhje me:
  - a. vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve sipas Ligjit për Statusin;
  - b. vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve sipas përcaktimeve të nenit 49 të ligjit për Statusin;
  - c. përvoja e magjistratit në pozicione drejtuese të sistemit të prokurorisë;

#### ç. vlerësimet e mëparshme.

Sipas kriterit të renditjes të parashikuar në këtë pikë, kandidati me totalin më të lartë të pikëve në dy vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale, renditet më lart.

### Neni 27

#### Prokurori i komanduar

1. Përvoja si prokuror i komanduar, si prokuror në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit konsiderohet si përparësi në renditje sipas nenit 24, të [kësaj rregulloreje](#), vetëm në ato raste kur prokurori ka kryer të gjithë periudhën e komandimit ose të mandatit.
2. Prokurori konsiderohet se e ka kryer të gjithë periudhën e komandimit edhe në rastin kur Këshilli, kryesisht, për shkaqe të shpallura në momentin e komandimit, ka përfunduar komandimin e tij para afatit.

### Neni 28

#### Kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e dytë

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 26 të [kësaj rregulloreje](#), ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvoja profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë.
2. Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart. Përvoja profesionale fillimisht vlerësohet sipas [kohëzgjatjes në atë shkallë](#) për të cilën po zhvillohet procedura e lëvizjes paralele.

### Neni 29

#### Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e tretë

- Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas nenit 28 të [kësaj rregulloreje](#), ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, Këshilli rendit kandidatët sipas vjetërsisë si magjistrat. Kandidati me vjetërsinë më të madhe renditet më lart.
2. Vjetërsia si magjistrat është treguesi që individualizon meritat e kandidatit në procedurën e lëvizjes paralele sipas kohëzgjatjes që ai ka ushtruar detyrën e prokurorit ose gjyqtarit, pavarësisht llojit të pozicionit.
  3. Treguesi i vjetërsisë [vlerësohet](#) me radhë sipas kriterëve të mëposhtme:
    - a) vjetërsia në detyrën e prokurorit;
    - b) vjetërsia në detyrën e gjyqtarit.
  4. Në vlerësimin e vjetërsisë në detyrën e prokurorit ose gjyqtarit sipas këtij neni përfshihet edhe përvoja në një pozicion të komanduar.

### Neni 30

#### Vjetërsia si jurist

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas nenit 29 të [kësaj rregulloreje](#), ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe renditet më lart.

### **Neni 31**

#### **Intervista nga Këshilli**

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 26 të kësaj rregulloreje, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta Komisioni paraqet në Këshill listën e kandidatëve të radhitur deri në këtë fazë.
2. Këshilli njofton për intervistë kandidatët dhe pas intervistës bën vlerësimin e tyre, duke vendosur përfundimisht për renditjen e kandidatëve [me shumicën e votave](#).

### **Neni 32**

#### **Hapat e renditjes së kandidatëve me një vlerësim etik dhe profesional**

1. Për renditjen e kandidatëve me një vlerësim etik dhe profesional ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7 dhe 8, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim.
2. Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.

### **Neni 33**

#### **Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë**

1. Renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar njëkohësisht në vlerësimin krahasues të:
  - a) rezultativitetit të vlerësimit etik dhe profesional përkatës;
  - b) në rastin e prokurorit të riemëruar sipas nenit 36 të ligjit për statusin, që përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit, që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar, do të ketë përparësi;
  - c) renditjes në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional.
2. Për kandidatin e komanduar dhe, kur është rasti, edhe atë të riemëruar, sa i përket vlerësimit etik dhe profesional, zbatohen rregullat sipas nenit 24 të kësaj rregulloreje.
3. Sipas kriterit të pikës 1 të këtij neni, kandidati me rezultatet më të larta sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të kësaj pike, renditet më lart.
4. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:
  - a) “niveli i vlerësimit etik dhe profesional” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka nivelin më të lartë të vlerësimit etik dhe profesional, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, renditet më lart;
  - b) “përvoja si prokuror i komanduar nga skema e delegimit që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i

*Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar*”. - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

a) *“kohëzgjatja e përvojës si prokuror i komanduar nga skema e delegimit që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar”* - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

ç) *“shumëllojshmëria e përvojave si prokuror i komanduar nga skema e delegimit që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ose si prokuror i komanduar”* - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

5. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 4 të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet:

a) në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli në lidhje me :

- vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve sipas ligjit për Statusin;

- vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve sipas përcaktimeve të nenit 49 të ligjit për Statusin;

b) në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar. Sipas kriterit të renditjes të parashikuar në këtë pikë, kandidati me totalin më të lartë të pikëve në vlerësimin etik dhe profesional dhe në vlerësimin përfundimtar të Shkollës së Magjistraturës, renditet më lart.

### **Neni 34 Komandimi**

Përvoja si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit, konsiderohet si përparësi në renditje sipas pikës 4 të nenit 33 të [kësaj rregulloreje](#), vetëm në ato raste kur prokurori ka kryer të gjithë periudhën e komandimit. Prokurori konsiderohet se ka kryer të gjithë periudhën e komandimit edhe në rastin kur Këshilli, kryesisht, për shkaqe të shpallura në momentin e komandimit, ka përfunduar komandimin e tij para afatit.

### **Neni 35 Kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e dytë**

Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 33 të [kësaj rregulloreje](#), ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë.

Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart. Përvoja profesionale fillimisht vlerësohet sipas [kohëzgjatjes në atë shkallë](#), për të cilën po zhvillohet procedura e lëvizjes paralele.

### **Neni 36 Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e tretë**

Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe sipas nenit 35 të kësaj rregulloreje ka më shumë se një

kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si magjistrat. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart. Zbatohen rregullat e parashikuara në pikat 2,3 dhe 4 të nenit 29 të [kësaj rregulloreje](#).

### **Neni 37**

#### **Vjetërsia si jurist**

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas nenit 36 të [kësaj rregulloreje](#), ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe renditet më lart.

### **Neni 38**

#### **Intervista nga Këshilli**

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 37 të [kësaj rregulloreje](#), ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta Komisioni paraqet në Këshill listën e kandidatëve të radhitur deri në këtë fazë.
2. Këshilli njofton për intervistë kandidatët dhe pas intervistës bën vlerësimin e tyre, duke vendosur përfundimisht për renditjen e kandidatëve, [me shumicën e votave](#).

### **Neni 39**

#### **Hapat e renditjes së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional**

Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kritereve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë rregullore.

### **Neni 40**

#### **Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë**

1. Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.
2. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

*a) “përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit për prokurorët të cilëve i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit, që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar pasi ka kryer të gjithë periudhën e komandimit”. -Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;*

*b) “shumëllojshmëria e përvojave, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar”. - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;*

*c) “kohëzgjatja e përvojës, si prokuror në skemën e delegimit, si anëtar i Këshillit, si Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose si prokuror i komanduar”. - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.*

3. Përvoja si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit, konsiderohet si përparësi në renditje sipas pikës 2 të këtij neni, vetëm në ato raste kur prokurori ka kryer të gjithë periudhën e komandimit. Prokurori konsiderohet se ka kryer të gjithë periudhën e komandimit edhe në rastin kur Këshilli, kryesisht, për shkaqe të shpallura në momentin e komandimit, ka përfunduar komandimin e tij para afatit. Zbatohen rregullat e parashikuara në pikat 2,3 dhe 4 të nenit 29 të kësaj rregulloreje.
4. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 2, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.

#### **Neni 41**

##### **Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit**

1. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele, relatori kujdeset në veçanti për:

- a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, që gjendet në dosjen e tyre personale apo që paraqitet nga ata gjatë procedurës së përzgjedhjes;
- b) përgatitjen e relacionit që përmban përshkrimin e dokumenteve të administruara, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për renditjen e kandidatëve, duke i bashkëlidhur atij kopje të këtyre dokumenteve;
- c) përgatitjen e projektvendimit të renditjes së kandidatëve;
- ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;
- d) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;
- dh) njoftimet për kandidatët.

2. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas nenit 19 pikat 2,3, 7 të kësaj rregulloreje.

3. Në përfundim të vlerësimit për çdo kandidat, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e administruar, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve.

#### **Neni 42**

##### **Shqyrtimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve**

Për shqyrtimin nga Komisioni të projektvendimit të renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat e nenit 20, të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 43**

##### **Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve**

1. Për shqyrtimin nga Këshilli të projektvendimit të renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme

rregullat e nenit 21 për pikat 1,2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.

2. Këshilli vendos për miratimin e projektvendimit të renditjes të kandidatit sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtari. Në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

#### **Neni 44**

### **Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe e drejta e ankimit**

Për vendimin e renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat e nenit 22 të [kësaj rregulloreje](#).

## **KREU V**

### **FAZA E TRETË E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE**

#### **Neni 45**

### **Vendimi i transferimit**

1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart.

2. Vendim i Këshillit i njoftohet prokurorit të transferuar, prokurorive respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Një kopje e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të prokurorit të transferuar.

#### **Neni 45/1**

### **Përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar**

Këshilli vendos përfundimin e një procedure pa vendim përfundimtar në rastet e mëposhtme:

- a) kur nuk është paraqitur asnjë kërkesë për atë procedurë, brenda afatit të caktuar;
- b) kur në vijim të procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, nuk mbetet asnjë kandidat në atë procedurë;
- c) kur vendi i shpallur nuk është më i lirë;
- ç) në të gjitha rastet e tjera e parashikuara me ligj.

## **KREU VI**

### **DISPOZITA PËR PERIUDHËN KALIMTARE**

#### **Neni 46**

### **Rregulla të përgjithshme**

1. Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25, paragrafi 3 i ligjit nr. 48/2019, për renditjen e

kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele zbatohen rregullat sipas Kreut IV, të kësaj rregulloreje, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë Kre.

2. Për zbatimin e kriterëve të renditjes së kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale, si rregull konsiderohen vlerësimet e bëra sipas Ligjit për Statusin. Vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale të kandidatit të realizuara përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin, konsiderohen të vlefshme për efekt të kësaj rregulloreje.

3. Në rast se, në një procedurë të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele të paktën një nga kandidatët nuk ka asnjë vlerësim sipas ligjit për statusin dhe vlerësimet e tij janë konvertuar sipas parashikimeve të nenit 24 dhe 47 të kësaj rregulloreje, atëherë vlerësimi i çdo kandidati tjetër në atë procedurë, që është bërë sipas ligjit për statusin, do të konvertohet sipas tabelës së mëposhtme

Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (ligjit për statusin):	Niveli i vlerësimit pas konvertimit për efekt të procedurës së ngritjes në detyrë:	Pikët, pas konvertimit për efekt të procedurës së ngritjes në detyrë :
Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	100
Shumë mirë	Shkëlqyeshëm	100
Mirë	Mirë	69
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	49
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm	29

#### Neni 47

#### Konvertimi dhe pikëzimi

1. Konvertimi i niveleve të mëparshme të vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional me ato sipas sistemit të vlerësimit në fuqi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Niveli i vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional :	Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi ( ligjit për statusin):
Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Mirë	Mirë
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm

2. Niveli i vlerësimit konvertohet në pikë sipas sistemit të vlerësimit në fuqi ( Ligjit për Statusin) si më poshtë:

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

Mirë	69
Mjaftueshëm	49
I pamjaftueshëm	29

#### **Neni 48**

#### **Kandidatët e caktuar përkohësisht**

~~Për kandidatët e caktuar përkohësisht sipas nenit 59 të Ligjit për statusin përpara miratimit të kësaj rregullore për transferimin nëpërmjet procedurës për lëvizjen paralele, nuk do të aplikohen dispozitat e nenit 59 pika 6 dhe 7 të Ligjit për Statusin. shfuqizohet~~

#### **Neni 49**

#### **Lëvizja paralele në vendet e lira të përkohshme**

Kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë rregullore zbatohen për sa është e mundur edhe për vendet e lira të përkohshme.

#### **Neni 50**

#### **Të fundit**

~~1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. shfuqizohet~~

2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.